



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:240469

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06493466

2022:049173

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1660-12/19, e dt.18.10.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 20.11.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu dhe të pandehurit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 22.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.S., nga i ati I., e ëma H., e gjinisë B., i lindur më në Ferizaj ku dhe tani jeton rruga “ nr....., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në botën e jashtme, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal:, i dënuar më parë për veprë penale falsifikim i dokumenteve, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 27.06.2019, rreth orës 02:16, të pandehurit Sh. I. dhe B.S. takohen së bashku me N. I. në Kafiterinë “” në rrugën”” në Ferizaj, ku fillimisht konsumojnë pije dhe më pas u afrohet një djalë i ri, i cili i pyet “ a po doni diçka me pi” dhe pasi që i pandehuri Sh..... i thotë “ Po”, naj Xhoint (cigare me marihuanë) dhe ia jep këtij personi 2 euro, të cilat i kishte lënë në tavolinë i pandehuri B... dhe më pas personi në fjalë e lëshon në tavolinë një qese me marihuanë dhe një letër mbështjellëse. Dhe kur të pandehurit dalin nga lokali dhe fillojnë për të pirë cigare me marihuanë, ndalen nga patrulla policisë, me ç’rast i pandehuri B... e kishte pasur cigaren në dorë kurse i pandehuri Sh... e hedhë cigaren dhe qesen me pjesën e mbetur të substancës, e cila në bazë të ekspertizës së Asgjensionit të Forenzikës të Kosovës të datës 11.10.2019, rezulton se ka qenë marihuanë në peshë 0.93 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 ,70 dhe 269 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

GJYKON

Me Dënim me gjobë në lartësi prej 200 € /dyqind euro/, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën atëherë konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-se, gjykata do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 €/ njëzet euro/ të pa paguara, do e vuaj një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €uro /njëzetë euro/, ndërsa në emër të kompensimit të Viktimave të Krimit shumën prej 20 € (njëzetë euro), në kuptim të nenit 36 par. 3 nen par. 3.1, Nr. 08/L-109, të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, i konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike me peshë prej 0.93 gram, e cila i është gjetur të pandehurit gjatë kontrollës nga policia.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1660-12/19 e dt.18.10.2019, ka ngarkuar të pandehuri për shkak të kryerjes së veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhen veprat penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 20.11.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i cili ka deklaruar se pas shikimit të aktit akuzues, provave dhe të gjitha shkresave që i janë bashkangjitur si dhe duke e analizuar të kaluarën kriminale të tij e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës nga evidenca e policisë shihet se i njëjti nuk ka ndonjë rast tjetër, andaj dhe në këtë rast e bëj rikualifikimin e veprës penale nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, në nenin 269 par. 2 të KPRK-së, dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale posedim i

paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, është hera e parë që jam takuar nga policia për përdorim të narkotikëve edhe pse unë më herët para kësaj kohe kam përdor narkotik, mirëpo tani kam kuptuar se përdorimi i këtyre është tejet i dëmshëm për shkak se unë nga ky përdorim kam pasur probleme shëndetësore dhe tani edhe pse në Gjermani ku jam përkohësisht është i lejuar përdorimi i narkotikëve unë them se definitivisht nuk jam duke e përdor më dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të tillë apo të ngjashme, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është e mundur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare në pajtim me dispozitat e nenin 242 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit dhe në kuptim të nenit 69 dhe 70 të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Gjithashtu në kuptim të 269 par.3 të KPRK-së , substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto 0.93 gram të konfiskohet në mënyrë të përhershme.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, raporti i oficerit i 2019-DHTN-412, i dt.27.06.2019, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurve i dt. 27.06.2019, Rraporti i ekspertimit të agjencionit për forenzik të Kosovës i dt.11.10.2019, fotodokumentacioni i lëndës me referencë me sasinë e narkotikëve të sekuestruar, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve i dt.27.06.2019 dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye

ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. (nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale, për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e singertë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit veprë të tillë apo të ngjashme, ndërsa rastin konkret si rrethanë renduse gjeti se i pandehuri më parë ka qenë i denuar me aktgjykimin 2023:061615 të dt. 24.08.2023 për veper penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 të KPRK-së, dhe është denuar me denim me gjobë, e që kjo u veretua nga Ekstraktet mbi denimet penale për të pandehurin, të nxjerrur nga Departamenti i Evidences Qendrorre Penale të KGJK-së, dhe përveç këyre rrethanave gjykata vlerësoj edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërisë së saj dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskim, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi mbi kompenzimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 pika 3.2 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit Nr. 08/L-109.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2022:049173, datë 22.11.2024**

**Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.